



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 16.09.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

"Asfaltim i rrugëve në fshatin Rrushkull "

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Punime rrugore 45233140-2*

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,332,534.82 (tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë tetëdhjetë e dy) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës 2026.

Argumentimi: MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.285, datë 13.07.2026, nr. 9740 prot., ndryshuar me urdhrin Nr.365, datë 25/08/2026, me Nr.9740/2prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t'u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit, dokumentet sipas Buxhetit të Bashkisë të vitit 2026 të miratuar nga Këshilli Bashkiak për fondin limit, shqyrtoi dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuara nga grupi i punës i projektimit në Bashkinë e Durrësit.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të specifikimeve nr. 318, datë 28.07.2026 nr. 97401 port., ndryshuar me urdhrin Nr.366, datë 25/08/2026, me Nr.9740/3 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në VKM nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 8,332,534.82 (tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë tetëdhjetë e dy) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 30 (tridhjetë) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin ; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për të paktën një nga dy vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Asfaltim i rrugëve në fshatin Rrushkull”. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së Asfaltim i rrugëve në fshatin Rrushkull, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare 2024, 2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet

nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteri është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve.

2.2.3 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.*

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Referuar rekomandimit të APP-së nr.3261/5 prot., datë 27.11.2025 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik”, pika 3 e tij “Për hartimin e kërkesave të veçanta”, Fq 4.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit të kontratës që prokurohet me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

Për sa i përket kapaciteteve të tjera teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrin nr.318, datë 28.07.2026 nr. 97401 port., ndryshuar me urdhrin Nr.366, datë 25/08/2026, me Nr.9740/3 prot.,të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP 1 A Punime gjërmimi në tokë;

NP 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;

NS 18 A Punime topogjeodezike;

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te dorëzojë licencat profesionale sipas zërave te preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër te realizoje.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente te kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne këtë forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve

KATEGORIA E	PERSHKRIMI I KATEGORISË	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN	NIVELI I KLASIFIKIM	VLERA E PUNIMEVE QË
-------------	-------------------------	--	---------------------	---------------------

KËRKUAR	SIPAS LEGJISLACIONI T TË FUSHËS	NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	IT I KËRKUAR PËR KATEGORIN Ë RESPEKTIV E	PARASHIKOHE N TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-A	Punime gërmimi në tokë;	-Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri -Shtrese stabilizant t=10cm -Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri -Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	A 0-20 milionë lekë	1,232,038.82 LEKE
NP. 4-A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;	-Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me makineri. -Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri.	A 0-20 milionë lekë	7,100,496.00 LEKE
N.S.18-A	Punime topogjeodezike;	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rlevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të

paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për personelin kryesor, drejtues teknik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit, stabilizantit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder apo edhe për rrugën Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant binder dhe asfalt. Gjithashtu duke qenë se do të rikonstruktohen disa rrugë njëkohësisht si dhe në njërën do të ketë ndërhyrje përforcuese të terrenit dhe rrugës nevoja si drejtues teknik të një inxhinieri ndërtimi bëhet domosdoshmëri.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura) 1 (një)
- b. Inxhinier gjeodet 1 (një)

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë

- | | |
|--|-------------------|
| a. Teknik Ndertimi | 1 (një) |
| b. Asfaltoshtrues (punëtorë asfalti) | 2 (dy) |
| c. Eskavatoriste | 1 (një) |
| d. Automakiniste | 1 (një) |
| e. Buldozeriste | 1 (një) |
| f. Shofere | 1 (një) |
| g. 1 (një) punonjes, i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise | |
| h. 1 (një) punonjes, i çertifikuar “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. | |
| i. Punëtores ndertimi te thjeshtë | 5 (pesë) punonjës |

Për punonjësit e specializuar/të kualifikuar e mësipërm, Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune të vlefshme;
- Diplomë profesionale, certifikatë ose dokument tjetër që provon kualifikimin profesional, lëshuar nga institucione të licencuara sipas legjislacionit në fuqi ose ekuivalente;
- Certifikatë të sigurimit teknik, të lëshuar nga subjekte të akredituara nga DPA ose organizma ekuivalentë ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, kur kërkohet sipas profilit të punës.

Për punonjësit shofer duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Leje drejtimi e vlefshme;
- Certifikatë e aftësisë profesionale ose patentë manovrimi e lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur shoferët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për manovratorët eskavatoristë duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Dëshmi aftësie profesionale për përdorimin e makinerive të rënda, sipas legjislacionit në fuqi dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Në rastin kur manovratorët janë të kontraktuar për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për punëtorët e thjeshtë duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre prej 30 ditë. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike. Konkretisht: **Inxhinier ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura)** Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore dhe infrastrukturore të rrugëve, referuar preventivit të punimeve (Punime ndërtimi, Germimi).

Inxhinieri gjeodet është kërkuar me qëllim realizimin e rievimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.

Tekniku i Ndërtimit është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore në baze të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.

Tekniku gjeodet/topograf është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë piketimit të rrugëve që do të rikonstruktohen dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.

Asfaltoshtuesit janë të nevojshëm për punimet e shtresave asfaltike sipas zërave të preventivit.

Manovratori eskavatorist është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si eskavator germimi, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive.

Manovratorë automakinist-te nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si rrulla etj.

Drejtuesit e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion etj

Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin të objektit.

Buldozerist- shërben për mjetin e kërkuar buldozër.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” janë kërkuar duke u mbështetur në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këto kontrate ku dhe numuri i punojësve

te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 17 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Numri prej 17 punonjës përfshin 5 punëtorë të thjeshtë + 12 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, manovratorë dhe hidraulikë përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe

regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 17 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar ne katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport). (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtës min 25 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
2	Kamioncina me kapacitet 3.5-5 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
3	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
4	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
5	Minieskavator	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
6	Rrul ngjeshes gome - cilindër	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
7	Rrul ngjeshes gome - cilindër i dhembëzuar	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
8	Rrul asfalti cilindër - cilindër asfalti	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
9	Buldozer	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
10	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
11	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qira	Cope	1

12	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
13	Grejder (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
14	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
15	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	Cope	1
16	Fabrike Asfalti (e pajisur me leje mjedisore)	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	Cope	1

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve në kantieret në të cilët është e shpërndarë puna objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

b) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Nr	Lloji i makinerive	Argumenti
1	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 25 Ton	Transport dheu (Janë të nevojshem per transportin e materialeve te ndryshme te dala nga germimet apo materialet qe do importohen ne objekt)
2	Kamioncina me kapacitet 3.5-5 Ton	Transport materialesh: ndertimi,(Eshte i nevojshem per transportin e materialeve te ndryshme dhe transport punonjesish.)
3	Fadrome me goma	Eshte i nevojshem per ngarkimin e materialeve te ndryshme ne kamioncina, dhe spostimin e materialeve te ndryshme ne rruge
4	Eskavator me goma	Germim dheu me ekskavator (Eshte i nevojshem per germim ne trupin e rruges dhe hedhjen e materialeve ne mjete transportuese
5	Minieskavator	Germim dheu me ekskavator
6	Rrul ngjeshes gome - cilinder	Eshte i nevojshem per ngjeshjen e stabilizantit i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,
7	Rrul ngjeshes gome - cilinder i dhembezuar	Sherben per ngjeshjen nga poshte lart Ka "këmbë" ose dhëmbë metalikë në cilindër
8	Rrul asfalti cilinder - cilinder asfalti	Përdoret për të ngjeshur, sheshuar dhe lëmuar shtresat e asfaltit ose dheut gjatë ndërtimit të rrugëve
9	Buldozer	Shërben për të shtyrë, niveluar dhe pastruar dheun, gurët ose mbetjet në kantieret e ndërtimit, rrugë
10	Autobitumatrice	Eshtë një mjet ose kamion i specializuar që shërben për transportin, ngrohjen dhe shpërndarjen e bitumit ose emulsionit bituminoz në punimet e ndërtimit dhe shtrimit të rrugëve, është një kamion i specializuar që përdoret në ndërtimet rrugore për shpërndarjen e barabartë të bitumit ose emulsionit të bitumit në shtresat e rrugës përpara se të hidhet asfalti
11	Asfaltoshtuese	E nevojshme për shtrimin me asfalt
12	Autobot Uji	Për furnizimin me ujë në vepër gjatë punimeve
13	Grejder (mjet teknologjik me targa)	Eshte i nevojshem per hapjen e materialeve si cakull e stabilizantit ne trupin e rruges

14	Motogjenerator	<i>Për furnizimin me energji elektrike në vepër</i>
15	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	<i>Për të siguruar furnizim me material inerte në vepër rërë, si çakëll, rere, stabilizant etj)</i>
16	Fabrike Asfalti (e pajisur me leje mjedisore)	<i>Për të siguruar furnizim me material asfalt në vepër</i>

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçense lëshuar nga QKL: “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”, “Kodi III.2.B”, së bashku me aktin e miratimit.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” së bashku me aktin e miratimit në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: *Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është referuar preventivit të punimeve, duke qenë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu.), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, dhe kryerjen e transportit të tyre në vend depozitimit e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata si mëposhtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.

- c. Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018/45001-2023** "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
- d. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 39001:2012** "Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor" e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zërave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.2 germa "a"- "d" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018/45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor”.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Shënim: Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha normat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standardeve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit DPS, në ato raste kur këto standarde janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); dhe nenit 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), grupi i punës, i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor, hartoi Specifikimet Teknike për realizimin e objektit: *Asfaltim i rrugëve në fshatin Rrushkull* ", duke përcaktuar qartë kërkesat teknike, materialet, standardet dhe metodat e zbatimit që duhet të respektojë operatori ekonomik fitues, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme, sipas nenit 3 dhe nenit 36, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit